



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL NR. 7**  
Rrogozhinë, më 26.10.2023 ora 14 : 00<sup>oo</sup>

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

**Rendi i ditës :**

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.3809 .Prot datë 203.10.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.6, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 19.09.2023.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5-Miratimi i projekt – vendimit, “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtje civile”
- 6- Të ndryshme.

**Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :**

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Bajazit Thaçi, Besnike Coraj, Saimir Cani, Ferdi Avdiu, Sokol Gosa, Mitat Daja, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Renato Kalemi, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

**Mungojnë :**

Lije Dedej, Lulzim Hasa, Fatbardha Sina, Shpati Kolgega

**Të ftuar :**

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.



2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social.
3. Fatmir Mecaj- Drejtor i Arsimit
4. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vadijtjes.
5. Orges Tosku - Drejtor i të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
6. Adriatik Leka- Shefi i Emergjencave Civile
7. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
8. Mario Meka - Përgjegjës i zyrës IT.
9. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.

### **Drejton mbledhjen :**

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 17- Këshilltarë.

## **HAPET MBLEDHJA**

**Mukades Gixhari .** Përhëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë e kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët: z. Hekuran Xhani, znj. Silvana Aliu, z. Indrit Dedej, z. Bajazit Thaçi, znj. Besnike Coraj, z. Saimir Cani, z. Ferdi Avdiu, z. Sokol Gosa, z. Mitat Daja, z. Altin Tosku, znj. Gezime Met-hasani, znj. Alime Hoxha, z. Enver Memolla, znj. Fatmira Thartori, z. Renato Kalemi, z. Erind Tosku, Mukades Gixhari, i pranishëm në mbledhje edhe kryetari i bashkisë z. Edison Memolla.

**Mukades Gixhari.** Lexojmë verifikimin ligjor të ardhur na prefekti I qarkut Tiranë për mbledhjen e kaluar. Vendim nr . 17 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi I bllok ndihmës 6% është në përputhje me ligjin. Vendim nr . 18 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i pushtetit vendor është në përputhje me ligjin.

Vendim nr . 19 . Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat është në përputhje me ligjin.



Vendim nr . 20 . Për dhënie autorizimi Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë me objekt: Hartimin, nënshkrimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet Bashkisë Rrogozhinë dhe avokaturës së shtetit për të autorizuar e legjitimuar avokaturën e shtetit për të nënshkruar, depozituar rekursin për ta përfaqësuar Bashkinë Rrogozhinë në Gjykatën e Lartë të RSh është e drejtë e kryetarit të bashkisë nënshkrimi I kontratave, marrëveshjeve... referuar nenit 9 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” I ndryshuar dhe jo kompetencë e Këshillit Bashkiak.

Vendim nr . 21 . Për pagimin e shpenzimeve të varrimit nuk konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetë qeverisjen Vendore” i ndryshuar dhe ligjit Nr. 9220, datë 15.04.2004 “ Për administrimin e shërbimit të varrimit” ndryshuar në ligjin nr. 80/2014, datë 17.07.2014.

Vendim nr . 22 . Për një ndryshim në vendimin Nr.77 datë 27.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023 ” është në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore i ndryshuar, me Ligjin nr. 9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

Vendim nr . 23 . Për miratimin për servitut kalimi në pasurinë nr.1/187, zona kadastrale 3234, lagja nr.1, Rrogozhinë të kërkesës së z. Agron Aliu konfirmohen në parim, për zbatimin e vendimit duhet të referoheni në nenin4 të ligjit nr. 77/2022 “Për disa shtresa dhe ndryshime në ligjin nr 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”

Vendim nr . 24 . Për dhënien e opinionit mbi propozimin për planin e ri tarifor për Ujësjellësin Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a me Nr.4244.Prot datë 28.08.2023 konfirmohet në parim si e drejtë e Këshillit Bashkiak për tu shprehur mbi pronat që zotëron dhe planin tarifor, referuar ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin prefekti Afrim Qëndro.

Para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, do ju njoftoj se është i pranishëm drejtori i Bujqësisë z. Elton Xhani për të relatuar informacionin e ardhur në këshill në mbledhjen paraardhëse, gjithashtu kemi edhe në shqyrtim problematikat në Arsim z. Fatmir? Është njoftuar ia kemi cuar edhe shkresën zyrtare, gjithashtu kemi të pranishëm edhe përgjegjës in e Emergjencave Civile z . Adriatik Leka ka ardhur?

**Adriatik Leka. Po.**

**Mukades Gixhari.** Për të shqyrtuar problematikat e ngrijtura nga këshilltaret mbi dëmet e shkaktuara nga zjarret në bashkinë tonë. Gjithashtu kemi dhe drejtorin e Financës z. Rezart Vogli, këto çështje do të trajtojmë të gjitha me radhë në pikën 5 të rendit të ditës “Të ndryshme”. Para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës kam dërguar sot në WhatsApp në grupin tonë të këshillit projekt - vendimin ku bëhet fjalë për blerjen e një eskavatori për bashkinë tonë mirëpo kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak.



**Sokol Gosa.** Kryetare?

**Mukades Gixhari.** Po z. Sokol.

**Sokol Gosa.** Ne kemi kërkuar një apo dy mbledhje rreshtë një përfaqësues nga arsimit në bashkinë tonë, e quaj të papranueshme neglizhencë apo edhe indiferencë që zotëria të mos marri pjesë edhe sot në mbledhje, nuk e di. Tani derisa ky zotëria nuk na “bëgenis “ atëherë do të mbajmë edhe ne qëndrimin tonë përderisa problemet në arsim janë shumë të mëdha dhe ai të mos vijë do mbajmë edhe ne qëndrimin tonë.

**Edison Memolla.** Për një pjesë të arsimit do të ju jap unë përgjigje.

**Sokol Gosa.** Kryetar, unë them për drejtorin, ti ke pjesën tënde ai ka pjesën e tij kështu që nuk mund ti mbulosh dot ti të gjitha pjesët. Jo jo ai është përgjegjës dhe duhet të ishte këtu e kemi kërkuar dy mbledhje nuk na ka ardhur, e treta nuk na ka ardhur përderisa ai nuk e bëgenis Këshillin ...

**Edison Memolla.** Në rregull, nëse është kështu unë do të mar masat e duhura.

**Sokol Gosa.** E treta...

**Edison Memolla.** Po , shumë e drejtë. Tek ky projekt-vendimi që po flisni mund të shtoj dicka para se të dalim tek arsimit? Jeni dakort ta fusim në rend të ditës?  
Atëherë është një projekt-vendim që ka ardhur për emergjencat civile ne na sjell emergjenca civile një fond të caktuar për të bërë investime në bashki, e kemi shumë të nevojshme. Duke parë që kanalet në bashkinë tonë janë me shumicë dhe janë kanale që duhen pastruar kemi menduar që këtë fond ta marim një skrep 22 tonë,<sup>23,24,25</sup> në bazë të asaj shume që ka rakorduar dhe ta përdorim vetëm për pastrimin e kanaleve, në të gjithë fushat dhe rrugët që do të kemi nevojë duke krijuar një bord kullimi një sektor që nuk e kemi, do të jetë pjesë vetëm e pastrimit të kanaleve prandaj ne e shikojmë të arsyeshme të bëjmë një investim të tillë sepse duke patur një eskavator në dispozicion për 12 muaj mund ta bëjmë edhe me orar të zgjatur mund të kemi mundësi ta rishikojmë këtë punë. Ne menduam të gjithë bashkë me drejtorinë e Bujqësisë dhe në bazë të kërkesave të njëpasnjëshme të juaja, të personave që kanë probleme me tokat me përmytjet, si dhe nga shiu mbrëmë që kemi patur problematika të ndryshme. Jemi në pjesën e blerjes së këtij eskavatori që do të na shërbejë shumë, pastaj do të funksionojmë me një program pune në bazë edhe të zonave si kemi fushën e Gosës, Lekaj apo Sinaballaj dhe Rrogozhinës që patëm një muaj, një muaj e gjysëm me një eskavator të thjeshtë kemi bërë rreth 15 km rreth një muaj punë që na e la në përdorim Ministria e Bujqësisë. Të ta miratojmë këtë.



**Adriatik Leka.** Është fondi i kushtëzuar që nuk na lejohet ta përdorim për asgjë tjetër, vjen nga emergjencat civile vetëm për këto investime.

**Erind Tosku.** Ky fond në qoftë se nuk e kalojmë në rend të ditës sot dhe nuk e miratojmë digjet?

**Edison Memolla.** Po

**Adriatik Leka.** Afrohet fundi i vitit.

**Edison Memolla.** Atëherë ky fond duhet të përdoret para 31 dhjetorit, ka një procedurë që ndiqet në rrjetet online sepse do të blihet sepse ka dhe periudhën e kohës një muaj pas miratimit prandaj është e mira ta kalojmë sa më shpejt, tani nuk e di shikojeni...

**Mukades Gixhari.** Z. Ferdi

**Ferdi Avdiu.** Ne nuk jemi në kundërshtim me këto blerje sepse janë në funksion të komunitetit mendimi im personal, është e drejtë të aprovohet kjo sepse kjo duhet në të gjithë bashkinë si nga bujqësia e cdo gjë, e rëndësishme është që të përdoret për këtë gjë.

**Mukades Gixhari.** Atëherë e hedhim në votim? E fusim në rendin e ditës jeni dakord? Të gjithë Pro? Miratohet.

- *Miratohet me 16 vota pro, 1 kundër përfshirja në rendin e ditës të projektvendimit, “ Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”.*

**Mitat Daja.** Nuk janë të gjithë pro.

**Mukades Gixhari.** Z. Mitat?

**Mitat Daja.** E kaluat si procedurë vazhdojeni, por nuk ishin të gjithë pro.

**Mukades Gixhari.** Tani z. Mitat ju jepni mendimin tuaj .

**Mitat Daja.** Jo nuk kam gjë tani ajo u miratua, kaloi por nuk ishin të gjithë pro.

**Ferdi Avdiu.** Kjo është për ta futur në rend dite, pastaj votojmë s’votojmë kjo është gjë tjetër.

**Mukades Gixhari.** Z. Mitat kjo ishte për ta përfshirë në rendin e ditës pastaj do të votohet.



**Mitat Daja.** Blerjet ne i fusim kështu në rendin e ditës por ka edhe gjëra të tjera që duhet ti diskutojmë unë e kam thënë...

**Mukades Gixhari.** Do t'i diskutojmë me rradhë të gjitha mësues Mitati tani po fillojmë.

**Mitat Daja.** Mirë na falni për injorancën e procedurave këtu...

**Mukades Gixhari.** Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? Mësues Mitati jeni dakord?

Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 17-vota pro, pika e parë e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari .** Miratim i procesverbalit Nr.6, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 19.09.2023. Bëhet fjalë për mbledhjen e herës së kaluar, verifikimin ligjor që lexuam të ardhur nga Prefekti. Jeni dakord për miratimin e procesverbalit? E hedhim në votim. Pro, kundër? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 17-vota pro, pika 2 (dy) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari .** Kalojmë në pikën e tretë, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit social z. Ledian Hasani. Po do të na relatojë drejtori i Financave z. Rezart Vogli.

**Rezart Vogli.** Përshëndetje të gjithëve, duke qenë se komisioni para dy ditësh ishte përgjegjësi i shërbimeve sociale është diskutuar besoj në komision në lidhje me ndihmën ekonomike.

**Alime Hoxha.** Po, u mbledh komisioni para dy ditësh sipas njoftimit të nxjerrë u diskutua dhe është rënë dakord për dhënien e ndihmës ekonomike të këtyre familjeve sipas listës së nxjerrë.

**Mukades Gixhari.** Znj. Alime, po.

**Alime Hoxha.** Në këtë komision nuk ishte drejtori i Financës i pranishëm, ne ngritëm një kërkesë për rritjen e fondit të ndihmës ekonomike për familjet e trajtuara, nuk e di sa është fondi për këtë vit, nuk më kujtohet megjithatë Lediani më tha që do të jua sjelli fondin dhe do ta rrisi për familjet e përfshira në 3% dhe 6%.



**Edison Memolla.** Atëherë kemi mbledhje gjithashtu dhe dëgjesë publike për pjesën e buxhetit dhe të gjithë ju mund të bëni propozime të ndryshme në fusha të ndryshme dhe ta rishikojmë në planin buxhetor të vitit të ardhëm dhe të shikojmë ato që janë më emergjente normalisht janë shumë por duke zgjidhur ato më prioritaret që shkojnë drejtpërdrejtë komunitetit dhe zgjidhin problemet sa më shpejt. Normalisht shtresa në nevojë familje janë shumë por nuk është vetëm kjo zgjidhje ne po punojmë edhe me zyrën e punës duke i ofruar punë këtyre personave se nuk është vetëm të marim ndihmë ekonomike se nuk është zgjidhje, në zyrën e punës ka 100 vende të lira pune i marim në tel këto persona të paraqiten në punë disa u përgjigjen disa jo, ato që nuk përgjigjen herën e dytë apo të tretë meren masa që edhe mund të përjashtohen nga ndihma ekonomike. Idea është që këto të integrohen dhe të mos presin nga ndihma ekonomike sepse ka punë në privat, ndoshta duan në shtet për në shtet nuk rregullohen dot të gjithë por privati ka goxha vende të lira pune dhe mund të jetë një shtysë më shumë për këto familje, duhet të veprojmë të gjithë në këtë pjesë që ti themi të shkojnë në zyrën e punës që e kemi poshtë e kemi aktive cdo ditë, dhe ato njerëz që kërkojnë ndihmë ekonomike ato që nuk kanë mundësi fizike të shikojmë ndihmën ekonomike, por ato që kanë mundësi fizike dhe moshën për të punuar ti integrojmë me punë që të kenë një rrogë.

**Alime Hoxha.** Edhe dicka tjetër, meqënëse jam edhe kryetare e komisionit të ekonomisë ne kishim kërkuar projekt propozim për projekt buxhetin për vitin e ardhëm dhe për paketën fiskale.

**Edison Memolla.** Po e kemi në shqyrtim.

**Alime Hoxha.** Ne e kemi kërkuar dhe duhet ta kishim që këtë mbledhje sepse ne realisht të dhëna për këto duhet të na kishin ardhur që në muajin Maj. Është kërkuar në mbledhje dhe e kemi ngritur në mbledhje si problem, e kemi kërkuar që edhe të kishim një projekt propozim për paketën fiskale dhe buxhetin për vitin 2023, realisht duhet të kishte filluar që nga Maji ne nuk kemi akoma asnjë ide se çfarë do të bëhet me projekt buxhetin për vitin e ardhshëm, keni nxjerrë vetëm atë shpalljen që me datë 22 kemi konsultim publik por që ne si komisioni i Ekonomisë nuk kemi asnjë informacion.

**Edison Memolla.** Ai veprim, ajo shpallje i është paraqitur të gjithëve dhe jo vetëm komisionit të Ekonomisë që të dinë se çfarë po bëhet..

**Alime Hoxha.** Duhet të di se çfarë diskutohet tek komisioni, po flas në emër të komisionit.

**Mukades Gixhari.** Z. Enver?

**Enver Memolla.** Mar shkas nga përvoja e vitit të kaluar që kam qenë kryetar komisioni duhet të



dini dicka paketa fiskale është pikënisja e buxhetit të vitit të ardhshëm dhe pa dijeni të paketës fiskale i bie që muaji nëntor të mbyllet për ta dëgjuar si paketë fiskale për të bërë ndryshime si profesion apo si këshill Bashkiak në lidhje me punët dhe me buxhetin sepse në afatet kohore janë të limituara deri në fund të muajit Shtatorit edhe muajit që kaloi.

**Mukades Gixhari.** Po z. Dedej

**Indrit Dedej.** Sa për ndihmën ekonomike flasim në emër të atyre njerëzve që janë pa takat dhe të cilët nuk kanë mundësi punësimi, se s'ma do menja se dalin njerëz që mund ta bëjnë punën nuk do të shkojë dhe të japim ne ndihmën, duhet që për këto të shkojë të paktën që përfitojnë të shkojë të paktën tek 8 mijë lekë.

**Enver Memolla.** Kjo ishte detyrë për personat përgjegjës të shikojmë anën ligjore, pastaj dëgjesa...

**Edison Memolla.** Nuk është problem ajo lloj pjese, Ledio mere bashkë me financën këtë propozim të mirëqenë maksimumi që në mbledhjen e ardhshme ose në rrjetet sociale që ju keni në grupet e ëhatapp të thoni që maksimumi tavani i kësaj është këtu, besoj se ka mundësi ngritjeje.

**Ledian Hasani.** Kur ishim në mbledhje komisioni pardje e diskutuam këtë pjesë me e ngritur nuk mundemi momentalisht sepse nuk mundemi sepse të ja kalojmë atyre që sa përfitojnë në sistemet ekonomike.

**Edison Memolla.** Po mund të shtohen afërsisht sa...?

**Ledian Hasani.** Po mund të shtojmë numrin e familjeve, po në qoftë se është e mundur nga ana financiare.

**Sokol Gosa.** Kryetare?

**Mukades Gixhari.** Po

**Sokol Gosa.** Për mua paketa fiskale duhet të kishte ardhur jo këtë mbledhje por edhe më para, jo më kot jemi këshilltarë dhe buxheti është një nga pikat më kryesore që duhet të ishte diskutuar edhe këtë muaj edhe muajin e kaluar, nuk e kuptoj këtë neglizhencë apo mosbesim ndaj kësaj pike që është imediate për bashkinë tonë, nuk mund të kalojmë në probleme apo çështje të tjera para kësaj, e mira është që ti kishim trajtuar për të gjitha fushat, arsimin, ekonomisë e të gjitha





me rradhë ne nuk dimë si të veprojmë do të vijë puna që në dhjetor të përplasen dhe janë ato letrat immediate, shpejt ta kalojmë mos e kalojmë, jo nuk veprohet kështu. Ka rregulla, nuk veprohet kështu duhet të kishte ardhur me kohë edhe ne duhet ta rishikojmë sa janë fondet si do shikohet, grantet etj me rradhë.

**Mukades Gixhari.** Z. Ferdi cfarë do të shtoje?

**Ferdi Avdiu.** Jam plotësisht dakort me mendimin e Sokolit, sepse ndodh e njëjta gjë me shkollat me arsimin edhe sot e kësaj dite nuk e dimë a janë sistemuar a nuk janë sistemuar shkallë emergjenca ... nuk e dimë akoma.

**Sokol Gosa.** Ne kërkojmë drejtorin e arsimit ai nuk vjen!!!

**Ferdi Avdiu.** Kjo është për të mirën e të gjithëve nuk është për të mirën...

**Edison Memolla.** Në qoftë se doni të flasim për shkollën, flasim edhe për shkollën në përgjësi. Gjatë viteve që jam në krye të bashkisë, në bashkinë tonë janë ndërtuar 7 shkolla të reja dhe një kopësht, të gjitha shkollat i kemi në Rrogozhinë që njëra ska mbaruar është drejt fundit dhe normalisht ka shumë nevojë që dhe shkollat e tjera të kenë dhe ne po shikojmë që një ndër ato shkolla që kanë shumë prurje fëmijësh sic është Spillea i kemi bërë një kërkesë jo më larg se sot Ministrisë që të mblidhen të gjitha fshatrat në një vend, që të mos ketë klasa si i thonë kolektive, në një klasë kolektive asnjë prej jush nuk e con fëmijën e tij, klasat të jeni parë e dytë e tretë e me rradhë. E njëjta gjë do të jetë edhe në Spille për të mbyllur këtë plagë që unë nuk jam dakort, të mbyllen shkollat dhe të bashkangjiten. Kjo nuk është në dorën tonë që shumë prej jush mund të thonë pse kanë ikur apo pse nuk kanë ikur...

**Ferdi Avdiu.** Më fal nuk është problem i shkollave, rradhën që kaloi këty dolën shumë probleme për shkollat që janë në funksion problematika që janë jashtë standarti.

**Edison Memolla.** Po pra po nga 15-16 shkolla që kemi, 8 i kemi bërë të reja normalisht nuk i bëjmë dot të gjitha të reja...

**Ferdi Avdiu.** Po shkolla re nuk mund të hapet dot pa shkallë emergjence, po i ke shkallët e emergjencës.

**Edison Memolla.** Po i ke shkallët e emergjencës.



**Ferdi Avdiu.** Rradhën që kaloi na thanë që ska i kemi bërë, e mira është që të jetë cdo drejtor përkatës dhe të thuhet ka probleme jo, është zgjidhur ky problem apo jo si e shoh unë sipas mendimit tim.

**Edison Memolla.** Si ti që je jashtë edhe unë e dimë se si janë shkollat, shkollat kanë disa kushte që patën, këto kushte nga shkollat e reja që ne kemi bërë janë 100% më të mira së ato që kanë qenë, por këto të tjerat kanë nevojë për fonde, po kanë nevojë për fonde dhe ne me atë po merremi se aq është edhe buxheti se nuk është që nuk duam punë se gjithsecili do që shtëpia e tij të duket mirë e bukur.

**Ferdi Avdiu.** Mjafton e duhet që drejtorat të jenë për këtë atë...

**Edison Memolla.** Eshtë e nevojshme të jepet informacioni në kohën e duhur.

**Ferdi Avdiu.** Ne nuk kundërshtojmë problematikat që janë por them kur të jenë këtu mos bëhet një mbledhje qesharake.

**Edison Memolla.** Në rregull shumë e drejtë.

**Ferdi Avdiu.** Që dhe ne kur të dalim të themi që në Këshill Bashkiak këtë problem e kemi zgjidhur.

**Mukades Gixhari.** Z.Sokol?

**Sokol Gosa.** Ta nisa me temën e shkollës, meqënëse hape muhabetin e shkollës, flas për shkollën time gjimnazin “Haxhi Qehaj” nuk e di ke firmosur apo jo për marrjen në dorëzim të asaj shkolle.

**Edison Memolla.** Jo

**Sokol Gosa.** Po të shikosh punimet e asaj shkolle janë nga më skandalozet, me atë fond që është hedhur në atë shkollë aty duhet të ishte bërë nga e para, aty ka mangësi të jashtëzakonshme, unë dhe Alimeja që japim mësim aty po vuajmë që nga lagështia, shkrirja e ziftit që janë bërë taracat, mungesat e terreneve sportive, tualeteve. Është bërë një punim nga forma më skandaloze në atë shkollë, aq shumë sa është abuzuar me atë shkollë “Haxhi Qehaj” nuk është abuzuar në asnjë shkollë tjetër të bashkisë tonë e para, e dyta tek 9 vjecarja erdhi puna se nuk është marrë mendimi i publikut u bë një bunker, një bunker pa pikën e turpit dhe ju do të mbani përgjësi në breza për atë palestër aty që u ndërtua para asaj shkolle, në vend se të bësh një lulishte, një park,



një mrekulli, gjelbërim argëtim për fëmijët.

**Mitat Daja.** Nuk ka ambiente femrash më mirë ka qenë.

**Sokol Gosa.** Tjetra, tjetra ajo punimet i ka cilësore se janë fondet e BE dhe kontrollohet nga inxhinierë të caktuar nga ato po që tek ai gardhi rrethues aty kush e bëri, cili është kuptimi i atij gardhi pa pikë estetike kush e bëri, ca hekura është shkollë institucion shkollor, edukohen fëmijët tanë breza me rradhë.

**Edison Memolla.** Cfarë problemi ka gardhi?

**Sokol Gosa.** Probleme nga më të mëdhajat janë, aty bëhet dicka e bukur pse nuk keni pyetur inxhinierë arkitektë që meren me këtë punë, apo me bunkerët që bëhen këtu. Kryetar më vjen keq por dëgjoj komunitetin e mësuesve atyre që vijnë nga arsimit dhe jo interesi personal apo momental.

**Edison Memolla.** Nuk kam asnjë interes personal.

**Sokol Gosa.** Ngjyra ikën e vjen por institucionet shkollore mbesin aty, kopshtet, cerdhet, shkollat duhet të jenë jo për tani por për 20 vite kjo është thelbësore. Sic u punua në atë shkollë “George Soros” të ishte punuar edhe tek “Qamil Gjuzi” apo tek gjimnazi “Haxhi Qehaj”. Në qoftë se keni firmosur është gabimi më i madh e keni marrë në dorëzim, ajo është as cereku i investimit. Nga një miliard që mund të ishte investimi aty është hedhur 100 milion 200 milion lekë.

**Edison Memolla.** Profesor në qoftë se po flet për shkollën Haxhi Qehaj nuk jam në dijeni dhe nuk jam marrë...

**Sokol Gosa.** Si nuk je në dijeni, anuk je pjesë e bashkisë sonë ti?

**Edison Memolla.** Po nuk jam marrë unë me pjesën e rregullimit, nuk është bërë në kohën kur kam qenë unë kryetar bashkie.

**Sokol Gosa.** Ok.

**Ferdi Avdiu.** Ne kemi kërkuar gjithmonë në mbledhjen e parë kryetar edhe për personat që kanë marrë në ngarkesë këtë shkollë kush është që ka firmosur a është abuzuar me këto fonde a s’është abuzuar, kush...



**Edison Memolla.** Kush ka shkelur ligjin atje të shkojë në vend.

**Ferdi Avdiu.** Atë kemi kërkuar edhe 2-3 mbledhjet e para prap vjen sot...

**Edison Memolla.** Ska ndonjë problem këtu kush e shkel atje të shkojë.

**Sokol Gosa.** Ne në atë shkollë gjimnazi nuk do bëhej shkallë emergjence nuk e di po ca u bë kanë shemb mure dhe u bë shkallë emergjence të nesërmen, kalojmë tek terreni sportiv etj etj me rradhë.

**Mukades Gixhari.** Znj. Silvana ?

**Silvana Aliu.** Përsa i përket shkollës sime, palestra kujt shkollë i përket?

**Edison Memolla.** Qamil Gjuzit.

**Silvana Aliu.** E sigurtë?

**Edison Memolla.** Po

**Silvana Aliu.** Shpresoj të mos i hiqet atyre nxënësve dhe ti kaloj të tjerëve.

**Edison Memolla.** Si hiqet askujt, atëherë palestra do të jetë pasi të ketë përfunduar unë do të hedh një propozim bashkë me ju që të përdoret edhe nga komuniteti jashtë shkolle jashtë orari mësimorë sepse mund të ketë të rinj apo të reja që...

**Ferdi Avdiu.** Në një institucion arsimorë është e pamundur kjo gjë.

**Mukades Gixhari.** Të rikthehem tek ndihma ekonomike dhe ta vazhdojmë pastaj. Po z. Enver?

**Enver Memolla.** Ishte një mendim nuk është se...

**Ferdi Avdiu.** E kuptoj por është e pamundur.

**Alime Hoxha.** E ke të lejuar me ligj arsimit mund ti jepni ato objekte pas përfundimit të procesit mësimorë, mund ti jepni për përdorim.

**Edison Memolla.** E vendosim bashkë.



**Ferdi Avdiu.** Jepet? Kujt do tia japi privatit?

**Alime Hoxha.** Jepet, jo bashkia ia jep punonjësit...

**Edison Memolla.** Një që ka mbaruar shkollën gjimnaz do të shkojë të luajë volejball në darkë.

**Alime Hoxha.** Ligjërisht jepet.

**Edison Memolla.** Sic shkon profesor Sokoli të bëjë stërvitje tek fusha kalçetit mund të jetë një profesor tjetër që mund të mësojë të luajë volejball.

**Mukades Gixhari.** Z. Enver po?

**Enver Memolla.** Znj. Kryetare faleminderit për fjalën por ndërhyrja ime është thjesht për procedurë. Ne sa bënë diskutim pjesën pikën 3 të rendit të ditës dhe dolëm jashtë konteksti ndaj duhet miratimi i kryetarit të grupit të opozitës kërkoi nga ne që të meren me pikën e rendit të ditës pastaj tek pika 5 tek “Të ndryshme “ të gjitha gjërat që kemi i diskutojmë sepse ka njerëz që na presin online dhe presin mendimin tonë. Vazhdojmë historikun e mbledhjes së ditës dhe çfarë ka problematika ne këtu jemi sot, nesër, pasnesër.

**Ferdi Avdiu.** Enver më fal këto problematika duhet ti kishe kapur më parë ndërkohë sot kërkoje dhe rendin e ditës, kemi 3 mbledhje 4 mbledhje që kërkojmë si tek drejtorat si tek mësuesit si tek arsimit e të gjithë të tjerat. Unë të kuptoj shumë mirë ty po kërkesat tona që kemi 3 mbledhje që i kërkojmë.

**Enver Memolla.** Po mirë pra, atë që kërkon ti unë nuk po ta mohoj por duhet respektuar rendi i ditës.

**Ferdi Avdiu.** Ti si kryetar me respektin tonë duhet ta kishe kërkuar dy mbledhje më para këtë gjë, që opozita ka kërkuar këtë gjë ndërkohë që ske asnjë drejtor të japi mendim.

**Enver Memolla.** E kam kërkuar.

**Ferdi Avdiu.** Ku janë?

**Mukades Gixhari.** Janë këtu. Të flasi pak zoti Hekuran?

**Hekuran Xhani.** E nderuar kryetare, të nderuar kolegë në mbledhjen e kaluar lamë 3 detyra dhe



4 detyra si rregullore që duhet të ketë në dispozicion cdo anëtarë i këshillit bashkiak dhe ti përmbahet kësaj rregulloreje gjatë zhvillimit të mbledhjes së këshillit sepse duke filluar nga pika e parë dhe dalë tek të ndryshme dhe nga të ndryshme tek pika e parë i bie që problemet më të ndjeshme dhe më me rëndësi ti anashkalojmë në fundin e mbledhjes. Sekretari i këshillit duhet të kishte përgatitur dhe cdo këshilltarë pikat kryesore të rregullores duhet ti ketë dhe cdo këshilltarë është mirë të zbatojmë të gjithë bashkë rregulloren për ti dhënë seriozitetin dhe rëndësinë këtij këshilli. Në mbledhjen e ditës u la detyrë zyra e Arsimit cka do të diskutohet në fund presim të mbarojmë rendin e ditës pas rendit të ditës, përgjegjësit e Bujqësisë dhe një informacion nga procesi i legalizimeve, faleminderit kryetare.

**Mukades Gixhari.** Faleminderit z. Hekuran, sekretari është me leje dhe përsa i përket rregullores së këshillit secili anëtarë i këshillit rregulloren e ka në email personal, ka ndonjë nga anëtarët e këshillit që nuk i ka shkuar rregullorja?

**Ferdi Avdiu.** Jo e kemi të gjithë, besoj në rregull është.

**Mukades Gixhari.** Jemi tek pika 3 fond i ndihmës 6% e hedhim në votim? Pro , kunder, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 17-vota pro, pika 3 e rendit të ditës.*

**Vendim nr.25.** Miratohet me 17 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkruesë Nr.3803.Prot datë 20.10.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.

**Mukades Gixhari .** Kalojmë ne pikën 4, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë me përgjegjësi i sektorit z. Ledian Hasani.

**Ledian Hasani.** Ka gjithsej 19 familje përfituese dhe fondi është 72 mijë lekë të reja.

**Mukades Gixhari.** Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? Po z. Enver?

**Enver Memolla.** Kam vetëm një pyetje zoti Ledio, ajo që është kërkuar në komisionin e Ekonomisë pjesa ligjore mblidhet në rast se kemi prezent të gjithë këshilltarët për pjesën e buxhetit për këtë.



**Mukades Gixhari.** Pyetje tjetër për këtë pikë? E hedhim në votim? Pro, Kundra, Abstenim ? Të gjithë pro miratohet.

*-Miratohet me 17-vota pro, pika 4 (katër) e rendit të ditës.*

**Vendim nr.26.** Miratohet me 17-vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.3796.Prot datë 19.10.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.

**Mukades Gixhari.** Me pjesën e projekt vendimit që na ka ardhur për blerjen e eskavatorëve.

**Edison Memolla.** Kështu jua shpjegova, besoj se është e qartë?

**Mukades Gixhari.** E hedhim në votim?

**Sokol Gosa.** Një minutë kryetare.

**Mukades Gixhari.** Po z. Sokol.

**Sokol Gosa.** Z. kryetar nuk e di sa skrepa kemi në bashkinë tonë 1 apo 2?

**Edison Memolla.** Kemi një me zinxhirë dhe një me rrota.

**Sokol Gosa.** Kanë qenë efikas domethënë gjatë gjithë punës së tyre?

**Edison Memolla.** Shumica po, ka patur defekte teknike.

**Sokol Gosa.** Po ndërhyrje ka patur, ndërhyrje kështu jashtë programit mund të kenë bërë?

**Edison Memolla.** S’besoj.

**Sokol Gosa.** Domethënë ke patur 2 skrepa dhe të mos jenë bërë ato punime të paktën gjysma e punimeve...

**Edison Memolla.** Të shpjegoj dicka skrepi ka një krah që nuk e arrin të gjithë, ai krah pastron disa kanale Ferdi e di shumë mirë.

**Sokol Gosa.** Po, mirë këto me gjysëm krah që kemi ne a i kanë bërë të gjithë punimet?



**Edison Memolla.** Po i kanë bërë pjesën më të madhe të kanaleve, a ke ndonjë proces verbal ta japi se krah bën edhe rrugën edhe kanalet.

**Sokol Gosa.** Nga ana e rrugëve sa metra sa kilometra rrugë bën deri tani? Për kanalet do të shërbejë vetëm?

**Edison Memolla.** Atëherë ky është me krah të matur 22 ton deri 25 ton, në bazë të buxhetit që ne do të kemi. Ky do të shërbejë vetëm për kanalet e dyta.

**Sokol Gosa.** Burimet njerëzore që do ta përdorin këtë është gjetur.

**Edison Memolla.** Personi nuk është për tu gjetur sepse e kemi në administratë është shofër dhe dihet që kanë, duhet dhe patenta e këtij mjeti se nuk mund ta ngasi kushdo. Këto mjete që kemi ne nuk e bëjnë dot këtë pastrim sepse koha, largësia...

**Mukades Gixhari.** Z. Enver

**Enver Memolla.** Duke marrë shkas se kanalet e largëta menaxhohen nga bordi, sepse ne sot e kalojmë tek eskavatori i madh por duhet të marim leje si bashki me bordin e kullimit për mënyrën e veprat.

**Edison Memolla.** Veprat që ka bordi i kullimit normalisht duhet të kenë një marrëveshje mes tyre se nëse ato e sjellin mjetin ne vazhdojmë punën dhe në qoftë se ato nuk e sjellin ne do të vazhdojmë pastrimin.

**Enver Memolla.** Edhe në një projekt që patëm vitin e kaluar nga pastrimet që janë bërë poshtë pjesa e atij kanali që është bordi i kullimit duhet pastruar, dua të di për këtë pjesë duhet marrëveshje.

**Mitat Daja.** Deri tani është bërë pastrimi i këtyre kanaleve?

**Edison Memolla.** Nga bordi i kullimit sot që flasim janë duke futur tek rruga në Vilë Bashtovë që bën përmytje gjithmonë, që nga rrjedhja e lumit Shkumbin dhe nga komunikimet deri lart në autostradë, që të bëhet njëherë e mirë pastrimi i atij kanali sepse është ngërc që na ndodh vit pas viti të kemi përmytje, ta zgjidhim njëherë e mirë këtë pjesë se janë qindra hektarë që përmyten.

**Mukades Gixhari.** Po z. Mitat.





**Mitat Daja.** Fondi i emergjencave civile nuk përdoret për gjë tjetër vecse për blerje vetëm për blerje, supozojmë marim nje shembull sepse unë kam bërë gjithmonë pyetje dhe kam folur me Tikun privatisht sepse kanë ndodhur herë pas here zjarre gjëra kshu..

**Mukades Gixhari.** E kemi këtë pikë pas këtij projekt vendimit pasi të marim vendimin. Po z. Rezart.

**Rezart Vogli.** Përshëndetje të gjithëve, lidhur me projekt vendimin për përdorimin e Fondit të Kushtëzuar të akorduar nga Ministria e Mbrojtjes, drejtoria e agjensisë mbrojtjes civile është viti i dytë që bashkia Rrogozhinë përfiton fondin nga kjo agjensi. Më saktësisht për ndërhyrje në rehabilitim dhe mbrojtje të pronës private dhe me vendimin e fundit Këshilli i Ministrave mund të përfitojmë vec shtetas të ndihmuar banesë që janë dëmtuar ose rastet e zjarreve sic i parashtroui zoti Mitat. Qëllimi i këtij fondi është që ti vijë në ndihmë bashkive rastet ku kanë emergjentë. Nga viti i kaluar ne kemi patur një rast për shkak të afateve nuk mund ta zbatoshim kriterëve ligjore por duke qenë që me datë 17.05 Këshilli i Ministrave ka marrë një vendim nr 210 i lehton pak përdorimin e këtyre fondeve por që kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak duke qenë se jemi para këtij fakti si e parashtroui edhe kryetari i bashkisë është bërë takim dhe konsultim dhe është rënë dakort nga zyrat e bashkisë Rrogozhinë që është më e nevojshme blerja e një eskavatori.

**Mitat Daja.** Ashtu e keni gjykuar ju?

**Hekuran Xhani.** Sa është fondi?

**Mitat Daja.** Po presim emergjencat civile a ka ndonjë raport, deri tani a janë pastruar kanalet a ka pasur përmbytje ato që janë pastruar, për blerje e blejmë në vend ne nuk është problem problemi është bërë apo s'është bërë puna deri tani me këto me këto probleme që janë bërë ka patur ndonjë vlerësim dëmsh për njerëzit apo ska pas kjo është pyetja? Se kjo është të mbarojnë zjarret dhe përmbytjet do të ketë prap emergjenca tani në qoftë se do harxhohet ky fond për këtë gjë hajde... Unë flas ndonjëherë herë dhe thonë jo me letra pa letra zgjidheni ju si bashki pse janë pa letra.

**Edison Memolla.** Sa më shpejt për ta mbyllur si procedurë, tani o do ta djegim...

**Mitat Daja.** Po ju mos e sillni në minutat e fundit si do sillni buxhetin minutat e fundit dhe do të na detyroni ta miratojme me patjetër, se ashtu ka qenë me buxhetin minutat e fundit që të ngrenë dorën të gjithë. Kërcënimet që do digjen nuk do digjen, në qoftë se do digjet le të digjet.

**Ferdi Avdiu.** Është një mjet që duhet në bashki.



**Mukades Gixhari.** Na trego pak shumën e lekëve që është tek Fondi i Kushtëzuar Rezart?

**Rezart Vogli.** Fondi është 4 milion lekë dhe është për shpenzime marrje masash parandaluese lehtësuese, rehabilituese në objekte të ndryshme nëpërmjet blerjeve të materiale dhe shërbime të vyeshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës.

**Hekuran Xhani.** 40 milion lekë të vjetra.

**Rezart Vogli.** Po dhe kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak që njësia e bujqësisë së bashkisë Rrogozhinë bashkë me drejtorinë e financës fillojnë procedurat për blerjen e këtij mjeti.

**Erind Tosku.** Nuk e kuptoj pse i jepni kaq zë këtij muhabeti, tani ne kemi një fond për blerjen e këtij eskavatori ju thoni mos e ble, po kur na duhet na duhet tani po se morëm këtë fondin digjet dhe i bie se kemi dhe ne emergjencat civile po s'pate eskavator nuk punon nuk ke si punon si i ndihmon, as qytetarët, as zjarrin, as ullinjt e tuaj as të tjetrit.

**Mitat Daja.** Ju keni shumë qejf që të dilni kështu si heronj, mësuar si me ndihmën ekonomike.

**Erind Tosku.** Në qoftë se është fondi dhe ne blejmë një eskavator dhe e cojmë në bashkinë tonë, një eskavator tjetër që na ndihmon hajde ta kalojmë në votim në qoftë fillojmë me gjera të tjera unë personalisht jam pro.

**Mitat Daja.** Mbarove ti? Mund të flas unë? Atëherë ato që hiqen si heronj nuk është e drejtë të hiqen si heronj sikur po shpëtojnë Rrogozhinën nga përmytjet, puna është këtu, fjala është shumë e thjeshtë unë kam thënë edhe mbledhjen që shkoi drejtorja e emergjencave apo ku e di unë zyra e emergjencave ka një raport për dëmet e shkaktuara në bashkinë Rrogozhinë sepse njerëzit na kanë votuar na takojnë dhe na thonë që i është bërë dëm, i ka vlerësuar njëri këto dëme apo nuk i ka vlerësuar pastaj hajde blejmë eskavatorin që të parandalojmë dëmet e tjera. Nuk ka njeri kundër me blerë eskavatorë apo me bërë punime në bashki sepse secili mban përgjësi problem është që gjërat të bëhen me themel ose në qoftë se ju doni hë se u dogj unë nuk e pranoj dhe nuk e miratoj sikur ju 20 të bëheni në krah tjetër, unë nuk lidhem me asnjëri me këtë lloj pune dakord, në qoftë se ka njëri përgjigje ok në qoftë se jo vazhdoni.

**Edison Memolla.** Ka përgjigje edhe për atë Mitat, pak më vonë do të dalim edhe tek gjërat që janë bërë.

**Mitat Daja.** Para se të miratojmë këtë jepni përgjigje pastaj miratojmë këtë. Këto janë anashkalime..



**Hekuran Xhani.** Tani lidhur me çështjen e eskavatorin unë kuptoj edhe nga diskutimi i Mitatit që është tepër i sigurtë sepse bashkia Rrogozhinë i paska patur dy mjete, unë e dija një po qenkan dy, faktikisht kryetar përfitoj nga rasti meqënëse je këtu, gjëndja e kanaleve vaditëse është... Them ta diskutojmë çështjen e kanaleve me përgjegjësën e bujqësisë tani Mitati dhe gjithë ne grupi opozitës duam një eskavator që të punojë jo vetëm ditën por edhe natën të shërbejë qytetarëve të bashkisë Rrogozhinë. Por problemi është do ta blemë dhe do ta marim të flejë gjumë apo do ta blemë e do ta mbajmë të bëjë punë. Këtu këshilltarët e opozitës kërkojnë transparencë si në shpenzimet për atë eskavator, blerjen dhe në funksionim e atij eskavatori, ti shërbejë sa më mirë fermerëve dhe qytetarëve tonë, ky është qëllimi që do z.Mitat dhe i gjithë këshilltarëve të opozitës.

**Edison Memolla.** Dhe ne me mendimin e juaj jemi, do ngrihet një komision që do merret me çështjen e blerjes.

**Hekuran Xhani.** E dyta lidhur me çështjen e blerjes e mira është që vlera nga zyra e financës të jetë përcaktuar sa se këtu po vijmë...

**Rezart Vogli.** Jo ajo është maksimumi ne i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin tuaj për nisjen e procedurave për blerjen e këtij skrepi, ka disa procedura ligjore që...

**Ferdi Avdiu.** Që edhe nuk mund të pranohet.

**Hekuran Xhani.** Ky është një projekt vendim, asnjë vendim dhe duhet të keni parasysh zbatimin e ligjit, cdo vendim shoqërohet vjen projekt vendim shoqërohet me vlerën financiare dhe merret vendim për eskavatorin X do të shpenzohen kaq lekë, këshilli vendosi blerjen në parim dhe vlerën financiare sepse do të vijë kontrolli i shtetit ne kemi marrë vendim vetëm po shkruajte vlerën mbrapa sepse ne mund të thujmë e miratojmë atë dhe vjen 200 milion. Me 200 milion pjesa juaj s'është dakort se i dhimbset buxheti i bashkisë ne bëjmë vaki e votojmë. Domethënë ky është qëllimi që ne duhet të dijmë dhe vlerën.

**Edison Memolla.** Vlera maksimumi është 4 milion lekë të reja që janë 40 milion lekë, nuk shkon më shumë se aq lekë se kaq është fondi, nëse e blejmë më lirë aq më mirë se kto lekë që teprojnë shkojnë për ullinj të Mitatit.

**Mitat Daja.** Mitati ska ullinj sa për informacion, se ja sqarova edhe drejtorit të taksave.

**Hekuran Xhani.** Për çështjet e bujqësisë, kryesisht sistemin e mirëmbajtjes ullinjve dhe vaditjes ngrihet një komision nga këshilli për ti bërë transparencë si qytetarëve ashtu dhe këshillit këtu për të ndjekur punimet dhe të raportohet në këshill për cdo shpenzim që bëhet.



**Mukades Gixhari.** Atëherë e hedhim në votim të nderuar këshilltarë? Pro, Kundra? Atëherë një kundër.

**Mitat Daja.** Nuk jam kundër.

**Mukades Gixhari.** Abstenim mësues Mitati?

**Mitat Daja.** Abstenim sepse kur opozita pranon të bëhet një blerje pa pyetur njëherë njerëz afarë dëmsh kanë bërë emergjencat civile.

**Silvana Aliu.** Ta jap unë përgjigjen e opozitës, opozita nuk mund të marrë përsipër nesër pasnesër kur të ndodhë përmbytjet dhe të vijnë të na thonë që nuk e votuat.

**Edison Memolla.** Ky mjet do të përdoret për hapjen e rrugëve për të shkuar zjarrfiksja.

**Mitat Daja.** Shpresojmë.

**Mukades Gixhari.** Atëherë jemi 16 Pro dhe 1 Abstenim. Miratohet.

*Miratohet me 16-vota pro, dhe 1 abstenim projektvendimi, “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”.*

**Vendim nr.27.** Miratohet me 16 vota pro dhe 1 abstenim, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3899.Prot datë 26.10.2023 “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”.

**Mukades Gixhari.** Drejtori i Bujqësisë z. Elton Xhani, ta dëgjojmë pak drejtorin e Bujqësisë.

**Elton Xhani.** Përsëndetje të gjithëve!

**Edison Memolla.** Para se të fillojmë Eltoni është i ri do të relatojë për këtë periudhë kohe normalisht shumica e problematikave janë në fushën e Bujqësisë, i urojmë suksese.

**Elton Xhani.** Në përgjigje të shkresës tuaj që keni dërguar dhe drejtorat që kanë qenë para meje në drejtorinë e Bujqësisë, ai ju ka sjellë edhe informacionin që besoj se shumica nga ju e kanë parë, gjatë këtij viti në bashkinë Rrogozhinë janë pastruar rreth 6 km kanale kulluese dhe vaditëse e cila ka bërë të mundur prodhimin e 80 hektarë tokë bujqësore, kemi në proces kanalin kullues primar me nr. pasurie 517-519 272/1 me gjatësi 2.5 km i cili vazhdon nga burgu i



Rrogozhinës deri në lumin Shkumbin, për këtë kanal është pastruar vetëm 500 metra dhe është në proces me deri në përfundimin e të gjithë 2.5 km, do pastrohet në bashkëpunim me bordin e kullimit sic ju tha edhe kryetari pak më parë. Kanali kryesor primar K5 në njësinë administrative Gosë.

**Ferdi Avdiu.** Më fal pak, këto punime duhet të ishin kryer jo 500 metra...

**Elton Xhani.** Janë në vazhdim e sipër sepse...

**Ferdi Avdiu.** Jemi Tetor- Nëntor tani kemi shira, këto duhet të ishin pastruar ku janë duke punuar tërë javën ato, të bëhen në kohë punimet jo si puna e asaj punës kur i vjen veza...

**Elton Xhani.** Po dhe kanali kullues primar që ka bordi i kullimit që është kanali..

**Edison Memolla.** Kanali K5 ka nisur që pas shirave të kaluar është i gjatë mund të jetë gati 12 km nga lumi Shkumbin deri në autostradë dhe skrepi me krah të gjatë nuk mund të bëjë më shumë se 200 metra në ditë sepse është kanal me gjëresi dhë është i madh.

**Elton Xhani.** Në qoftë se shkon tani e shikon skrepin atje jashtë duke punuar.

**Ferdi Avdiu.** Atë s'kemi pse e shohim ne po ku kanë shkuar punimet.

**Elton Xhani.** Kemi pastruar kanalin Zambishë, gjatë muajit Tetor është bërë pastrimi i kanaleve me nr. pasurie 510/ 196 192 730 2013 me gjatësi 1.8 km nga autostrada deri tek derdhja e lumit Shkumbin pranë ish fabrikës së lëkurave ku është bërë i mundur kullimi i 60 hektarëve tokë bujqësore. Gjatë këtij kanali përvecse pastrimi që është bërë është mundësuar edhe rregullimi i dy urave me tuba për kalimin e banorëve në tokat e tyre bujqësore. Këto ishin që janë realizuar gjatë këtij viti tani problematikat sic jua tha edhe kryetari pak më parë sic i dini edhe ju vetë janë të mëdhaja, unë në bashkëpunim me njësitë administrative që i kam cuar shkresë njësive administrative dhe më kanë kthyer përgjigje për problematika të mëdhaja emergjente, kam parë që pastrimi i kanaleve kulluese primar i njohur si emrin kanali zogu me gjatësi prej 3 km nga fshati Sinaballaj dhe derdhet në lumin Shkumbin që mundëson kullimin e 45 hektarëve tokë bujqësore duhet të jetë i menjëhershëm dhe për këtë ne do të marim masa të menjëhershme gjatë muajit Nëntor- Dhjetor për pastrimin e këtij kanali. Kanali kullues primar me nr pasurie 504 me gjatë 620 metër linear I cili ndodhet 21g arrotondo dhe të con deri te pazari në derdhje të lumit Shkumbin besoj që e dini dhe si vendodhje që është kanali në Rrogozhinë edhe ai është problematikë shumë e madhe për pastrim. Pastrimi i kanali primar me nr pasurie 165 290/4 me gjatësi 3.4 kilometra mundëson kullimin e 45 hektarëve tokë bujqësore nga fshati Gosë e Vogël



deri në Kalush. Në plan për tu pastruar në bashkëpunim me drejtorinë e bujqësisë me bordin e kullimit është kanali kullues primar me gjatësi 10 kilometra i cili i vjen në ndihmë fshatrave Ballaj, Vilë Bashtovë dhe Rreth Greth i njësies administrative Kryevidh. Problematika të mëdha sic e di dhe Hekurani ka dhe Luzi i Madh. Problematikë më emergjente është kanali kullues sekondar me distancë 3.5 km ku kullon më shumë se gjysma e tokave bujqësore. Problematikë e madhe është kanali kullues sekondar i cili kalon përmes fshatit dhe ka rrezikshmëri të lartë për përmbytjen e disa lagjeve, distanca e tij është 1.3 kilometra. Problematikë më e madhe dhe më emërgjente është kanali kullues sekondar që vazhdon përmes tokave të Lekaj përmes tokave bujqësore Luz i Madh dhe më pas në fshatin Shkozë ku kullojnë tokat bujqësore të fshatit dhe më pas derdhen në kanalin kullues primarë. Distanca e këtij kanali është 3 kilometra, më emergjente kemi edhe situatën e kanalit kullues primar me gjatësi 2.5 kilometra që pret fshatin Rreth Greth i mesëm dhe Spille, kritike është edhe gjëndja e rezervuarit kemi folur edhe me administratorin pasi është bllokuar shkarkuesi kryesor dhe derdhjet e shumta rrezikojnë shembjen e digës në stinën e dimrit.

**Ferdi Avdiu.** Paske shumë probleme.

**Edison Memolla.** Atëherë këto probleme nuk vijnë se ne nuk kemi dashur ti bëjmë, është problemi i këtij mjeti që ne kërkojmë, mungesa e mjetit nuk na lejon mundësinë e pastrimit të këtyre kanaleve se janë kanale të mëdha dhe të larta. Me marrjen e këtij mjeti do e shikoni që brenda një viti kohor sepse aq pastrohen do e shikoni që në bashkinë Rrogozhinë e mbarojmë këtë histori dhe pastaj vetëm i mirëmbajmë. Normalisht mund të thoni se çfarë keni bërë gjatë kësaj kohe keni të drejtë por mjetet nuk kanë pushuar asnjë ditë, kështu që është e pamundur që ti pastrojmë të gjithë.

**Mukades Gixhari.** Z. Indrit.

**Indrit Dedej.** Unë kisha dicka për të shtuar sepse kjo u mor vesh kjo punë po nuk qe skrepi nuk pastrohet... Unë dua të di se sa hektarë tokë ullahtë keni verifikuar ju që janë djegur?

**Elton Xhani.** Atëherë ne kemi verifikuar me Adriatikun 20 hektarë tokë ullahtë në fshatin Ballaj edhe...

**Indrit Dedej.** Sepse në buxhetin që do të vijë i këtij viti ngremë...

**Elton Xhani.** Kemi ngritur një komision bashkë, unë Adriatiku dhe Arturi dhe kemi shkuar të gjithë ne terren.



**Mukades Gixhari.** Për emergjencat civile kemi Adriatikun.

**Elton Xhani.** I kemi verifikuar 20 hektarë tokë që kam qenë unë nga ky muaj që kam filluar punë.

**Hekuran Xhani.** Sa është buxheti tek sektori i bujqësisë, sa është realizuar ky buxhet deri në muajin Tetor e para, e dyta sa hektarë tokë bujqësore mbulon bashkia Rrogozhinë sepse po nuk ditën këta projektin e ri të buxhetit nuk do të dinë se si ta hartojmë dhe menaxhojmë pastaj.

**Mukades Gixhari.** Do të kthej përgjigje drejtori financës.

**Adriatik Leka.** Dëgjo këto vjet kemi miratuar planin e emergjencave civile një herë në pesë vjet, në mbledhjen e ardhshme po të doni ju fotokopjoj dhe jua sjell të gjithëve në tavolinë, aty kam të dhënat e tokës arë bujqësore për cdo njësi vendore numrin e banesave, shtëpive, të gjitha problematikën që ka bashkia Rrogozhinë e keni të përmbledhur që quhet plan i emergjencave civile e miratohet një herë në pesë vjet, ku aty futen pikat më të dobëta ku parashikohet gatishmëria ku duhet të ndërhyjmë, ndërhyjmë s'ndërhyjmë i ke të gjitha të gatshme. Unë pyeta se çfarë kërkohet në rend dite...

**Hekuran Xhani.** Kur të vijë rradha, tani është drejtori i bujqësisë, pra sa ishte buxheti për këtë vit që të kemi një ide edhe ne?

**Edison Memolla.** Do ta keni një përgjigje të saktë këtë bashkangjitur me atë që tha edhe Adriatiku.

**Rezart Vogli.** Në mbledhjen pasardhëse.

**Hekuran Xhani.** Na duhet edhe për buxhetin që do të kemi, duhen sipërfaqet që kemi arë, buxheti i këtij viti mbi bazën e këtij buxheti do të bëjmë atë zoti kryetar grupi do bëjmë dhe miratimin e buxhetit për vitin e ardhshëm.

**Mukades Gixhari.** Po z. Enver?

**Enver Memolla.** Tani unë kam dy pyetje dëgjova që kanali zogut i fshatit Sinaballaj, do të thoja që plani i Nëntorit do të bëhet apo është projekt Nëntor- Dhjetor?

**Elton Xhani.** Mendohet që në Nëntor të fillojnë punimet pasi është shumë emergjente, sa më shpejt të vijë aq më mirë.



**Enver Memolla.** Jemi në marrëveshje që do të bëjë bordi i kullimit apo do presim investimet e bashkisë?

**Elton Xhani.** Do të presim investimet.

**Enver Memolla.** Ok, pyetja tjetër është që në të gjithë raportin nuk pashë një raportim për pjesën e erozionit të tokës bujqësore me të vërtetë është shkaktuar një problem por a keni ndonjë projekt ju si drejtorja e bujqësisë sepse duket një problem pjesa e ndërhyrjeve të tokave dhe po të shikojmë kanalet Rrogozhinë dhe nuk e di a ka ndonjë projekt a janë të gjithë në dijeni a ka bërë bashkia kërkesën...?

**Edison Memolla.** Jo vetën aty por kemi edhe në Vilë Bashtovë që po afrohet, bashkë me rrugën Cermë.

**Altin Tosku.** Ka dhe në Cermë krahu lart.

**Edison Memolla.** Atëherë për problemet me erozionin do të thotë sepse i ka të shënuara aty.

**Mukades Gixhari.** Po z. Mitat?

**Mitat Daja.** Zysh se nuk e dëgjova mirë ku është duke punuar skepi tani?

**Edison Memolla.** Kush skrep? Bordi i kullimit në bashkëpunin po pastron komunën që ikim në Vilë Bashtovë.

**Mitat Daja.** Edhe dicka tjetër, se u morën vetën me kanalet Elton. E di ti Elton që një pjesë e mirë e tokave nuk kanë rrugë hyrëse dhe dalëse për tu futur tek njëra tjetra? Këtu kam një kërkesë e një grupi banorësh po ta jap që ta kesh parasysh këtë që kanë bërë një kërkesë për hapje rruge sepse nuk futen dot te toka e vet, po me pjesën e rrugës jeni marë ndonjëherë apo jeni marë vetëm me pastrime kanalesh.

**Elton Xhani.** Unë nga periudha që kam filluar në drejtorinë e bujqësisë nuk ka ardhur njëri të më thotë.

**Mitat Daja.** E pranon nga unë ë? Atë kërkesën shikoje dhe kije parasysh, shiko dhe rrugën se duhet dhe rrugë për të tokat dhe jo vetëm pastrimi i kanaleve nuk është vetën një janë një grup njerëzish që kanë ardhur.





**Mukades Gixhari.** Pyetje tjetër për zotin Elton, drejtorin e bujqësisë?

Po z. Altin?

**Altin Tosku.** Atëherë vetëm me skrepin punohet vetëm me kanalet përmytës apo edhe vaditës?

**Edison Memolla.** Vaditës nuk bëhen me këtë punë, ato përmytës janë...

Altin Tosku. Edhe vaditës janë..

**Elton Xhani.** Për pjesën e kanalit vaditës po punohet në pjesën e hyrjes së Rrogozhinës po bëhet argjinatura e kanalit gjithmonë aty ku është carë se ju e dini më mirë këtë pjesë, gjithmonë aty ku është carë po bëhet me beton për të ardhur në ndihmë gjatë pranverë verës.

**Edison Memolla.** Kanali Peqin-Kavajë, ka marrë disa fonde nga shteti dhe do të sistemohet me segmente sepse është nga më kryesorët për të gjithë tokat në Peqin, Rrogozhinë, Kavajë që bëjnë vaditjen.

**Hekuran Xhani.** Skrepat janë në gjëndje pune që të dy që kemi?

**Edison Memolla.** Sot që flasim janë në gjëndje pune të dy, kursë një që është në bordin e kullimit që është në krahun e djathtë që është në punë...

**Mukades Gixhari.** Faleminderit z. Elton. Tani z.Adriatik Leka përgjegjësi i Emergjencave Civile të na flasi për masat që janë në lidhje me zjarret dhe shirat e rënë kohët e fundit.

**Adriatik Leka.** Përshëndetje të gjithëve, vjet është miratuar në dokumenti i menaxhimit të rrishtit, një kopje e kanë patur të gjithë vjet, plani i emergjencave civile që ka afat pesë vjecar, kemi miratuar edhe grupin e punës për verifikim e të gjithëve sipas njësisë është bërë i gjithë verifikimi, emergjenca civile bazon në ligjshmëri në neni 45 të vitit 2019 të miratuar nga parlamenti dhe nga udhëzimi 3029 datë 16.05.2012 që bëhet fjalë për masat parandaluese të njësisë vendore. Te ky plan i emergjencave pasi bërë bashkëpunin me të gjitha zyrat, kemi marë informacione me të gjitha strukturat kësaj bashkie për emergjencat e punonjësve të bashkisë, arsimin, shëndetsisë te OSHE ne kemi nxjerrë problematikat e njësisë vendore si funksionon nga përgjegjësi deri tek punonjësi i fundit, kemi nxjerrë edhe të dhënat psh bashkia Rrogozhinë përbëhet njësia administrative Sinaballaj, Gosë, Lekaj, Kryevidh, Rrogozhinë. Popullsia totale është 41 mijë e 600 banorë sipas gjëndjes civile duke filluar vjet në fillim dhe në fund të vitit, sipërfaqja pastaj tokë arë, tokë kodrinore, pyje për cdo qeverisje vendore. Pastaj kemi tokë erozion kanale të para, dyta dhe të treta rrugë të asfaltuara, rrugë këmbësorë të gjitha të verifikuara me dokumenta për cdo njësi vendore. Lista e rezervave, vendodhja viti i ndërtimit gjëndja e tyre



në mënyrë të përmbledhur në mënyrë të verifikuar, popullata që ndodhet afër tyre në rast se del probleme. Unë po ju fus në linjë ta dini se çfarë bën dhe çfarë nuk bëjnë emergjencat civile, pastaj kemi popullsinë prap, sipërfaqet tokë kodrinore tani ne vjet parvjet kemi zotëruar një sërë problemesh për zyrën tonë por pjesa më e madhe mesa dëgjova është zjarri. Bashkia jonë si cdo vit preket shumë nga djegia e zjarrit sidomos pikat Sinabaj, Gosë, Kryeviidh dhe Lekaj. Një pjesë e tyre janë dëme por ligji parashikon fatkeqësi natyrore, por nuk parashikon debatet e njerëzve sepse shumë kur kemi hyrë në analizë të tyre debatet midis dy komfijve dhe zjarrvënica e qëllimshme, ne me skrep kemi shkuar e kemi dhe të fotografuara sepse ne për cdo ditë ne raportojmë në prefekturë dhe në Njësinë Kombëtare të Emergjencave Civile dhe të fotografuara, por që të shkosh tek qytetari për ta ndihmuar e para punës duhet të jenë të gjithë të rregullt por nuk janë të gjithë të rregullt nuk mjafton të zaptin një kodër ta mbjellësh ullinj dhe të vish të ankohesh në bashki, ka disa kritere duhet të jesh fermerë, nga npiti, projekt investimin bjerjen e fidanëve me firmë me tvsh etj etj deri në prodhim, mbjellja e tyre sipas distancave, sa ke punuar, sa herë ke pastruar çfarë punimesh ke bërë dhe çfarë masash ke marë ti për ta ruajtur pronën tënde dhe kur ti ke marë këto masa por fatkeqësia natyrore, rrëshqitja, rrufeja nuk janë në dorën tënde atëherë kemi apo skemi lekë do të vijmë ndihmë por jo cdo tokë e mblellë në mënyrën tuaj mund të sigurohet nga emergjenca civile sepse pavarisht ajo duhet të bëjë shumë letra që të vijë këtu edhe miratimi juaj prefektura ta kthen mbrapsh, tami më tepër ne do ngulemi te masat parandaluese sesa tëk ato shpërbyese sepse si mund të ndihmoj unë tek ai mullari i barit ti ke korr jonxhën po atje në mes së arës ke bërë kavalec bari, kush agronom ose kush specialisht bujqësi e mer përsipër të vlerësojë se sa metër kub barë ke patur ti pas djegies. Prandaj ai thot struktura.

**Mitat Daja.** Përgjigja jote është kështu, digjuni mbytuni...

**Adriatik Leka.** Përgjigja ime është parandalim, marja e masave të parandalojmë të pastrojmë jo të thurim me gardhe nëpër kodrat ku nuk ka ku të hyjë. Zjarri i fundit ku isha prezent në fshatin Ballaj, në dhjetë shtëpi tetë ishin të mbyllura ne kemi hipur sipër mureve për të bërë fikjen e zjarreve ato kishin 3 vjet pa ardhur dhe ishte tokë e pa pastruar, si të bëjmë vaditje ullirit kur atë e ka mbuluar ferra.

**Mitat Daja.** Tani këto janë gjëra të tjera, përgjigja është që ne nuk ndihmojmë kaq.

**Adriatik Leka.** Ne ndihmojmë brenda kuadrit ligjor.

**Ferdi Avdiu.** Në këtë zonë a ka fermerë që janë të kualifikuar me këto procedura?

**Adriatik Leka.** Po ka, ato që janë të rregullt me dokumentacion dhe kanë marë masat e duhura do të ndihmohen, bashkia ndihmon që nga ndihma më minimale që ta japin e deri sa të kenë fuqi,



ne jemi bashki që nuk kemi fuqi se 4% e buxhetit që ka bashkia jonë nuk dalin dot për kanalet. Ne kemi një sërë kanalesh po unë po kërkoj për hapjen e rrugëve që të ketë nevojë një ambulancë të shkojë sa më shpejt në vendin e zjarrit, ato dy lekë që do hedhim ta dijë Mitati duhet ti ruajmë për një banesë se larg qoftë me u djegur një banesë je i detyruar atë ta shpërblesh.

**Mitat Daja.** Unë mund ti mbjell ulla dhe ti lë aty dhe nuk është punë e jotja apo e imja...

**Adriatik Leka.** Sepse ke një plan biznesi.

**Mitat Daja.** Nuk i ndihmojmë, përgjigja është e shkurtër nuk i ndihmojmë.

**Silvana Aliu.** Nuk mund të regjistrohet duke paguar taksa sepse është tokë e zaptuar.

**Adriatik Leka.** Duhet të paguajë taksa, blerjet duhet ta bëjë me tvsh ose cjanë këto borde tani të reja, psh te kodra ka disa ulla atje 20 vjet as taksa as pastrim as ferra atje mora shembull se atij që është me procedura me letra do ti vijmë në ndihmë. Ditën që ka ndodhur ngjarja ai bie kërkesën kryetari jep urdhërin shkon komisioni verifikon verifikimin ia con komisionit të vlerësimit janë 3 komisione specialist sipas dëmit po qe ndërtim i mirë do vi po këtu shuma sa lekë keni jepini.

**Mukades Gixhari.** Z.Indrit Dedej

**Indrit Dedej.** Sa për historinë e mësuam kush ka letrat e përfiton për zaptimet e rrugëve ke bërë ndonjë kërkesë ti bashkisë se këto kanë zaptuar edhe varrezat?

**Adriatik Leka.** I kam bërë te plani i emergjencave e di sa rrugë duhet hapur kam ngritur problematikën për cdo njësi vendore sa rrugë duhet hapur sa kanale duhet të pastrohen tek plani i emergjencave kam konstatuar dhe kam vënë rrugë emergjente, parësore dytësore.

**Mukades Gixhari.** Në mbledhjen e radhës do të na e sjellësh.

**Hekuran Xhani.** Po buxheti për emergjencën?

**Adriatik Leka.** Nga problematikat gjatë gjithë vitit i bëj emergjencave ato vjet patën një fond tek 7 milion u dogj nuk u bë asgjë u dogj, si ky patëm një fond te 4 milionshi për problemet që unë jap bie fondi nqs nuk e përdor bie mbrapsh nuk të lën ta alokosh për muajin tjetër apo ta cosh në degë tjetër po për këto programe që kemi aluduar hapje kanalesh, hapje rrugësh, blerje



zjarrëfikësh vetëm për investim.

**Hekuran Xhani.** Jemi të qartë për të kuptuar mirë njëri tjetrin, lidhur me këto fonde janë Ministria e mbrojtjes the ti se janë?

**Adriatik Leka.** Po, vjet ka qenë Ministria e Mbrojtjes, këtë vit është Ministria e Rendit.

**Hekuran Xhani.** Ky fond ka ardhur 4 milion lekë të reja bazuar në shkresën dhe kërkesën që ke cuar ti atëherë meqë ne jemi këtu për ti shërbyer sa më mirë punës besoj se projekt buxheti miratohet vitin tjetër Mars -Prill kur e miraton qeveria por ne të shkojmë pranë kësaj zyre që të rrisim buxhetin e të ardhurave të emergjencave sepse ne jemi të dukshëm besoj kryetare që mos e mar fjalën 100 herë kemi shumë problematika dhe përfitoj që është edhe kryetari është këtu sot, kryetarë ti vetëm ske çbën, stafi dhe admistrata duhet të jenë të gjithë në terren në qoftë se do ta mbyllësh me sukses këtë detyrë që ke marrë, kanalet sekondare të paktën zona që mbuloj unë sekondare 10, 11,12,15 17, mbulojnë Luzin e Madh dhe Shkozetin, këtë rrjet vaditës bëhen në Mars-Prill po sjanë bërë, pikërisht iu drejtova atij përgjegjësi të zyrës po ai dje ka ardhur nuk e di, sa është buxheti për bujqësinë sa është realizuar sepse kanalet nuk janë bërë atje. Ai është banor i fshatit Luz kam dhe nderin dhe kënaqësinë ta kem këtu.

**Edison Memolla.** Mos e pranoni më në fshat.

**Hekuran Xhani.** Problemi është që gjëndja e tyre është e rënduar, shiu i parë sa më shpejt ky eskavatori sepse do futemi në emergjencë, zoti përgjegjës i zyrave të emergjencave me shirat që do të bien tek K5 K7 i ke rrafsh me nivelin e tokës edhe pastaj njerëzit duke u nisur me udhëzimet e qeverisë për shtimin e sipërfaqeve të mbjella të grurit për sigurimin e bukës në vend se janë të gjitha thuajse të punuara dhe të mbjella do të shkojmë pastaj në emergjencë ose në humbje të ndonjë fermeri që do i prishen fara, gruri dhe përgjësia pastaj do të kërkojë dëmshpërblim. Meqë jemi tek të ndryshme zoti kryetar një problem madhor që shqetëson qytetarët e bashkisë Rrogozhinë është OSHE një shi 2min të gjithë qytetarët janë pa drita se si do ta zgjidhim unë nuk ta kisha numrin por për qejf do të kisha telefonuar mbrëmë se je qytetari i parë i kësaj bashkie dhe ne nuk kemi ku shkojmë sot, ne tek ti do përplasemi. OSHE për mua është jashtë funksioni, miliona e miliarda lekë janë hedhur po vazhdojmë më keq se vitet 90 një shi 5 min edhe sot në 12 e 20 min tak 20 min pa drita, fatkeqsia më e madhe është që këtu ka ngelur dhe brezi i tretë një i sëmurë një invalid ato ngrihen pa drita bën vaki s'kanë fuqi me lëviz thyejnë edhe një këmbë, problemi i OSHE është emergjencë më shumë se emergjencat civile z. përgjegjës i emergjencave civile. Do të lutesha shumë. Faleminderit.



- *Për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike shkëputet transmetimi online nga faqja zyrtare në facebook e Këshillit Bashkiak dhe regjistrimi I mbledhjes bëhet direkt me laptop.*

**Mukades Gixhari.** Të gjithë drejtorat janë këtu në qoftë se keni ndonjë pyetje?

**Mitat Daja.** Kam një kërkesë unë për bashkinë, kam një kërkesë unë për bashkinë kam qëkur ka filluar shkolla, për shkollat nuk po flas më se... rrallë shumë rrallë e shikoj policinë bashkiake, është shumë e rrezikshme që kalamajtë dalin sidomos në pushim të gjatë edhe kur vijnë në mëngjes që nuk ka polic bashkiak që nuk bëjnë sistemimin e makinave se makinat do të kalojnë edhe kalamajtë do të kalojnë, është shumë e rrezikshme lërë atë janë dy shkolla 9 vjecare, qëllonjë që janë ato të rendit qëllon që nuk janë sepse ato dy janë, a është mundësia që policia bashkiake të vijnë aty...

**Edison Memolla.** Unë për këtë pjesë nuk jam në dijeni, fëmijët në orën e pushimit lejohen të dalin jashtë?

**Mitat Daja.** Po lejohen.

**Silvana Aliu.** Jo prit.

**Mitat Daja.** Deri tani janë lejuar.

**Silvana Aliu.** Nëse do e bëjmë si qytetet e tjera nuk lejohet.

**Erind Tosku.** Është me rregullore të brendshme të shkollës.

**Mitat Daja.** Atëherë mbyll derën, jeni gabim që në fillim pra, një minutë po më dëgjoni... Tani ne po flasim për faktin se si është ligji zgjidheni më vonë, fakti është që kalamajtë dalin në pushim të gjatë blenë gjëra edhe kur vijnë në mëngjes edhe kur dalin pushim të gjatë, lejohet s'lejohet pyet drejtorat mos u merr me mua me këtë punë, ky është fakti, sill policinë bashkiake aty në qoftë se është e mundur sill policinë bashkiake.

**Edison Memolla.** Dakort nëse do vendosni do i nxjerrim në këtë orë që ta dimë që i nxirrni se ne realisht nuk e dimë që i nxirrni.

**Mitat Daja.** Fakti është që ato dalin.

**Edison Memolla.** Nëse ju do vendosni sjellim policinë bashkiake aty.



**Silvana Aliu.** Nëse do ecim me qytetet e tjera nuk lejohet sepse fëmija, fëmija...

**Fatmira Thartori.** Ligjërisht, ligjërisht. Nuk lejohet sepse është në udhëzim.

**Mitat Daja.** Mos i nxirrni, s'është faji im.

**Ferdi Avdiu.** Nuk nxirren sepse fëmija duhet të jetë brenda institucionit shkollor sepse unë flas si prindër që i coj fëmijët në orën 8 në shkollë do dalin në orën 1, në orën 10, 10:30 dalin në pushim pësojnë një aksident pa lejen time...

**Enver Memolla.** Kjo është për arsye sigurie.

**Erind Tosku.** Cfarë do të bëjë bashkia?

**Ferdi Avdiu.** Në kuptimin e fjalës është nevoja të vihet rregull si gjithë shkollat e tjera, fëmijën në orën 8 e dorëzoj në shkollë.

**Mukades Gixhari.** Altin Tosku.

**Altin Tosku.** Një problematikë tjetër, është për kamionat me tonazhe të rënda nuk kanë rrugë ku të kalojnë, se tek ajo rrugë që kalojnë e prishin komplet atë pjesën se është me lule, nuk është me asfalt, një rrugë dytësore për kamionët është problem, kanë lëvizur ato gurët dhe është problem sepse po doli një, dalin të gjithë.

**Mukades Gixhari.** Po zonja Alime?

**Alime Hoxha.** Të ndryshmet meqënëse jemi po tek emergjencat, dje me shiun që ra të gjitha rrugët e qytetit u bllokuan, duhet vënë dorë te pastrimet e kanaleve sepse janë bllokuar, pjesa më e madhe të paktën në pjesën matanë është bllokuar.

**Altin Tosku.** Atyre s'ke cfarë i bën fare cdo gjë është momentale nuk e mbajnë dot ato.

**Alime Hoxha.** Nuk e di ndoshta ti si kryetar nuk e dinë po aty para tek big marketi ka një pusëtë që është bllokuar, e kam ngritur disa herë dhe me grupin e punës por meqënëse jeni këtu po ju vë në dijeni. Është pusëtë që është në rrugë nuk është privat.



**Mukades Gixhari.** Zoti Hekuran kishe dicka?

**Hekuran Xhani.** Për një shqetsim që është mbarë kombëtarë po si pjesë është edhe çështja e legalizimeve, sepse projektligji i ri rrit taksën e banesës me 50%, edhe qytetari duke qenë qytetar është i detyruar të zbatojë ligjin e shtetit duke paguar taksën, faktikisht paguan taksë për një banesë që nuk e ka të tijën, defakto i themi ne po ai nuk mund ta përdori atë banesë se nuk ka certifikatë pronësie kjo nuk është kompetencë sepse këto i përqëndruan I hoqën nga bashkia dhe i cuan tek zyra aluizmit për legalizimet dhe certifikatat por meqëse ti ke mundësi kontakti duke na përfaqësuar dhe ne si këshilltarë dhe qytetarë të kësaj bashkie cfarë po bëhet me legalizimin dhe pajisjen me certifikatën e pronësisë banesat e qytetarëve tonë sepse paguan taksë për dicka që nuk e kemi tonën me ligj ky është një problem shumë i madh nuk e di kryesisht zona ime.

**Edison Memolla.** Ky është një problem i përhapur është një problem që dihet dhe është një nga temat kryesore që do të marim masa, pjesa më e madhe i kanë kthyer shërbimet online duke mos patur mundësi për të hequr kontaktin me njerëz dhe duke ndenjtur larg që të mos krijojnë përplasje që të mos jenë pjesë e kësaj gjëje. Ne kemi patur normalisht në pjesën e kadastrës jemi munduar të bëjmë maksimalisht dhe disa ka ecur mirë se ka zona harta ju e dini shumë mirë, ne kemi harta të tjera diku ka harta të tjera sepse qeveria ndërrohet njëherë majtas njëherë djathtas dhe askush nuk e ka patur mendjen te kjo punë por tani jemi para këtij fakti që duhet sqaruar unë paguaj taksat unë jam nuk po kërkoj asgjë të paligjshme është pjesë që unë e kam ndjekur, vazhdoj ta ndjek dhe do ta ngre zërin jo vetëm ne si bashki, se të gjithë bashkitë e kanë ngrëjtur herë pas here këtë çështje dhe delegohet më lart në Ministri apo në të gjitha zyrat. Është e vërtet e drejtë duhet ndjekur edhe nga I gjithë stafi, ne dërgojmë herë pas here shkresa sepse shumë vetë marrin edhe kadastrën, certifikatën dhe ne kemi patur problematika që nuk e dimë që e keni marrë apo nuk e keni marrë kemi mosrakordim por gjatë kësaj kohe me kalimin online, është pak e vështirë si fillim sepse normalisht edhe brezi që ka mbetur është brezi i tretë unë ftoj që kush ka probleme me aplikimet ne kemi në bashki një zyrë arkivë i themi ne, kemi vajza, goca që ndoshta nuk ka pagesë që të shkoj ta bëj tek private këtë mund të vijë në bashki dhe ne e ndihmojmë është një gjë, I ndihmojmë që të ia lehtësojmë sa më pak këtyre personave që nuk dinë dhe nuk mundën që ti bëjnë.

**Mukades Gixhari.** Znj. Silvana?

**Silvana Aliu.** Atëherë përsa i përket drejtorit të Arsimit në bashkinë Rrogozhinë e morën cka do të thotë që drejtori i arsimit është mbi Këshillin Bashkiak ...



**Mukades Gixhari.** Kërkesën ia kemi dërguar 3 herë.

**Edison Memolla.** Në qoftë se keni dërguar njëherë këtë kërkesë do të ketë masa ndëshkuese nga unë.

**Silvana Aliu.** Lista e punëtorëve, kemi dhe këtë disa muaj që e kërkojmë.

**Edison Memolla.** Lista e punëtorëve ka të dhëna sensitive që do të thotë që më mirë ju ta shqyrtoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore.

**Adriatik Leka.** Kur miraton organikën, miraton shumën pa emra.

**Enver Memolla.** Kur miraton organikën, miraton strukturën dhe shumën pa emra.

**Hekuran Xhani.** E ngatërroi znj. Silvana organikën e bashkisë me listën emërore, kjo nuk do listë don të dijë numrin e punonjësve.

**Edison Memolla.** Brenda kësaj pakete skemi ctë shtojmë po kush don mund ta ftoj në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

**Indrit Dedej.** Për transparencë të qytetarëve të ngrihet një komision të bëhet verifikimi.

**Edison Memolla.** Unë po ju ftoj te zyra pa komision, nuk po ju them mos ejani nuk ka ndonjë gjë , keshtu po ju ftoj pa komision.

**Indrit Dedej.** Edhe ne kemi të drejtë.

**Edison Memolla.** S'po më kupton, komisioni është e drejta juaj unë po ju ftoj pa komision nuk po ju them...

**Indrit Dedej.** Do bëjmë cfarë thotë ligji.

**Edison Memolla.** Merini të gjithë e hajdeni.

**Indrit Dedej.** Vijnë ankesa nga qytetarë shumë qytetarë se unë e di shumë mire që duhet të meret një vendim nga këshilli dhe na lejon ligji të bëjmë verifikime...

**Edison Memolla.** Cfarë do verifikoni? Ato janë online apo jo? Janë online. Cdo vendim këshilli është online.





**Indrit Dedej.** Jo se dua unë po ka ankesa.

**Alime Hoxha.** Ka një komision të verifikojë vendimet që ka marë këshilli i mëparshëm?

**Indrit Dedej.** Po.

**Alime Hoxha.** Jo, ky funksionon kjo të ngrihet një komision të verifikojë vendimet e këshillit, vendimet e këshillit janë miratuar nga prefekti.

**Indrit Dedej.** Jo kto po punës e zyrës.

**Alime Hoxha.** Ok punën e zyrës ok është gjë tjetër.

**Edison Memolla.** Atëherë janë marë vendime këshilli sipas kohës, të ju shpjegoj pak punën si ka proceduar..

**Indrit Dedej.** Jo shumë pak kohë ti ndoshta ke qënë në Itali ka ardhur qytetari dhe me forcën e muskujve ka kërkuar një dosje që ti ke firmosur për lëvrimin e fondit dhe qenka një sekretari jot që unë nuk e njoh, hallexhiu që ti i ke bërë kontratën...

**Edison Memolla.** Ju flisni nga jashtë nuk e di ketë gjë.

**Mukades Gixhari.** Diskutim tjetër? Atëherë mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

## **MBYLLET MBLEDHJA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 45<sup>oo</sup> . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 01 orë ; 41 min ; 04 sek, I ndarë në dy video respektivisht në 01 orë ; 28 min ; 17 sek dhe 12 min ; 47 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 34 (tridhjetë e katër).

**Miratohet procesverbali**

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :**  
**Sekretari i Këshillit**  
**Ervis Shera**